

LUSHNJA EXPLORE



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Ky projekt mbështetet nga:

#ReLOaD

Programi Rajonal mbi Demokracinë
Vendore në Ballkanin Perëndimor



Lushnja

Një udhëtim në bukurinë
e natyrës dhe kulturës

Qyteti i Lushnjes ndodhet rreth 80 kilometra në juglindje të kryeqytetit, Tiranës, lehtësisht i aksesueshme përmes rrugëve dhe transportit publik.

Gjurmët me te vjetra te zbuluara në kodrat pranë qytetit, datojnë në periudhën Eneolitike 2900- 2100 p.Kr.

Qyteti i Lushnjës ka një klimë të ngrohtë, me temperaturë mesatare vjetore që arrin në 16°C, me verë të nxehtë e të thatë, dhe dimër të butë dhe të lagësht.

Vlerat e pasura të trashëgimisë historike, kulturore, etnografike, arkitekturore dhe natyrore të qytetit përbëjnë një bazë të fuqishme për zhvillimin e turizmit.



Lushnja në këndvështrim historik

Gjurmime mbi lashtësinë e qytetit të Lushnjës

Gojëdhënat që ende qarkullojnë tek më të vjetërit tregojnë se “qyteti fillimisht qe ngulur në kodrat e Virovës, në afërsi të Golemit dhe më vonë, thuhet se prej këtu banorët u vendosën pranë përroit (përroi që kalon mespërmas (tani njihet si përroi i Lushnjës)”. Një tjetër gojëdhënë shumë e përhapur, tregon për “Hanin e Salushes” si burim nga rrjedh dhe emri i qytetit Lushnjës. (Për Salushen, mendohet që ajo të ishte e veja e Pashait ose skllavja e tij, ose disa thonë vajza e tij). Ndonëse ekzistencën e hanit të saj të famshëm diku në tokat pranë Institutit e kemi të provuar historikisht dhe të mbështetur edhe në hartën e vjetër të qytetit, duket se rregullat gjuhësore nuk e lejojnë një shndërrim të emrit Salushe -Lushnjë. Natyrisht, debati mbetet i hapur. Përpos kësaj ekziston një tjetër gojëdhënë, e cila duket se është më e pranueshme nga këndvështrimi historik dhe logjika gjuhësore. Sipas saj, “qyteti fillimisht ka qenë i vendosur në kodrën e Vainit pranë Kishës së Madhe të Kuqe dhe prej këtu u shtri drejt perëndimit.

+ Po çfarë thonë gjetjet arkeologjike të zbuluara në kodrën e Vainit?

Objekti më i hershëm i zbuluar në territorin e qytetit daton në periudhën eneolitike. Por ky nuk është i vetmi, të tjerë objekte arkeologjike janë zbuluara afërsisht në të njëjtin vend dhe i përkasin një periudhe më të vonshme se periudha në fjalë. Në vitin 1989 në lagjen “Kadri Qystri”, gjatë hapjes së një kanali vaditës, u zbuluan gjurmë të periudhës qytetare ilire. Pas kontrollit të bërë nga arkeologu Perikli Çuko, përveç enëve qeramike u bë evidentimi i një varrezë të lashtë ilire. Sipas teknikës së ndërtimit varret ishin të thjesht pa ndonjë konstruksion të veçantë. Varrimi bëhej me vendosje trupi në tokë. Nga sondazhet që u bënë, u pa se inventari i materialit arkeologjik ishte i pasur. U mblodhën fragmente të shumta enësh, si funde skifos, kupash, amforash etj.. Këtu u gjetën dhe objekte të plota, dy lekit.

Gjetja tjetër është një enë e tipit Gutus (ushqyes për fëmijë) i cili ruhet pothuajse i plotë. Gjithashtu aty u zbulua edhe një terakotë burri e stilit arkaik. Sipas arkeologut P. Çuko, mendohet se varret i përkasin shek IV-III p. Kr, ndërsa materiali arkeologjik tregon se është përdorur qeramika e importuar nga Apolonia. Ai arriti në përfundim se varreza i përket “një vendbanimi të hapur ilir”.

+ Po e vazhdojmë me të tjera dëshmi.

Pak më distancë prej këtu në vendin e quajtur “Kodra e Kalifas” në vitin 1988 u zbuluan të tjerë varre antike. Varret për nga mënyra e ndërtimit ishin të tipit të thjeshtë e të zakonshëm, me dysheme të shtruara me tjegulla të tipit solenë (të shtrira), të mbuluar po me tjegulla në formë çatie. Nga studimi rezultoi se këto varre i përkasin periudhës së Antikitit të Vonë.

Sakaq në vitin 2003 Instituti i Arkeologjisë me qendër në Tiranë, organizoi kërkime në kodrën me toponimin “Vain” në Lushnjë. Shkak për këtë u bë një tasel mozaiku i cili tërhoqi vëmendje. Gjatë kërkimeve aty u zbuluan gjurmët e një bazilike të hershme si dhe mjaft fragmente enësh prej qeramike. Specialistët mendojnë se kjo bazilikë duhet të jetë ndërtuar midis shekujve IV – VI m. Kr. Në Tab I fig 5, 6 janë ilustruar objektet që i përkasin kësaj periudhe ato janë gjetur në afërsi të Bazilikës.



Faktet tregojnë se në Lushnjë ka pasur një bazilikë të hershme para 1500 viteve dhe një komunitet të vogël që i ka shërbyer. Pra kemi një “vend lutjesh”. Se kur u shkatërrua deri në themel nuk mund ta themi me saktësi.

Emri i Lushnjës dokumentohet për herë të parë në regjistrin osman të vitit 1431 (aty shënohet fshati Lusnia, 15 shtëpi banimi me rreth 100 banorë. Ky dokument vërteton se Lushja ishte në këtë periudhë. Mundet që Lushnja si vendbanim të jetë ndërtuar midis shekujve XII-XIII. Pranë qytetit ruhet një urë e kësaj periudhe. (Fig 8) Gjithashtu në kodrën e Vainit janë zbuluar nga arkeologët disa copa qeramike me bitum i perkasin shekujve XII-XIII.

Lushnja përmendet përsëri me të njëjtin emër, në një tjetër defter osman që mban datën më 1582. Mësojmë nga burimet historike se Lushnja në vitin 1679 kishte 17 shtëpi dhe me një popullsi afërsisht 150 banorë.

Fillimi i vitit 1701 e gjen Lushnjën me një popullsi të dyfishuar, por ajo ruante akoma karakterin e një fshati. Midis viteve 1728-1738 mendohet të jete ndërtuar kisha Shën e Premtes. Në këtë periudhë Lushnja përmendet si Çiflig.



Disa vite më vonë (1741), Sanxhaku i Vlorës përfshiu të gjithë shqiptarët e jugut nga Shkumbini deri në Delvinë. Kazaja e Myzeqesë varej nga ky sanxhak. Trojet e Lushnjës dhe të rrethinave të saj, u thirrën Nahija e Myzeqesë, qendër e së cilës u bë fshati Karbunarë. Në vitin 1744 Lushnja paraqitet si katund me 57 shtëpi dhe rreth 500 banorë, ndërsa Karbunara na paraqitet me 47 shtëpi. Në këtë periudhë Lushnja morri pamjen e qyteze të vogël ajo kishte një kishë dhe dy rrugë të shtruara me kalldrëm.

Afërsisht në vitin 1770, me nismën dhe mbështetjen e gruas së Kurt Pashës, Hanko Pasha, ngrihet xhamia e parë në Lushnje, e cila ka ekzistuar deri në vitin 1967. Lushnja përgjatë gjithë shekullit XVIII fillon gradualisht të zgjerohet dhe të marrë pamjen e një qendre të rëndësishme banimi dhe tregtie. Në vitin 1830, Lushnja citohet për herë të parë në Fjalorët enciklopedik evropian. Atu thuhet se “Lusnia” ka 200 shtëpi dhe është e banuar si nga myslimanët dhe të krishterët. Pra në vetëm një shekull kemi një trefishim të popullsisë e cila mund të shkonte afërsisht në 1800 banorë. “Qyteza” kishte rrugë me kalldrëm, një kishë, një xhami, një teqe, dhe dy puse uji për nevojat e vendasve. Numëronte katër varreza të vogla “publike” të vendosur anës kodrave. Në vitin 1848 në Lushnjë erdhi poeti dhe piktori i njohur Edwart Lear i cili qëndroi këtu për disa orë, për t’u nisur përsëri drejt Beratit. Ai e përshkruan Lushnjën (Lusnia) si një fshat të pajisur me hane për udhëtarët. Në vitin 1860 në Lushnjë u hap shkolla e parë, ku përveç mësimi të gjuhës greke, mësohej shqip në mënyrë të fshehtë. Shkolla në fjale ka qenë ngrihej afër kishës Shën e Premte. Mësuesit e parë ishin Ndin dhe Gori Ziu, babë e bir, nga Gorreja. Po në vitet 1860-1870 në Lushnje u hap dhe shkolla Mejtepe (shkolle fillore fetare osmane), ndërsa në Karbunare ishte e hapur një tjetër shkollë mejtepe pak vite më parë se ajo e Lushnjës.

Pas vitit 1870 Lushnja filloj te dallohej si qendër dhe te marre pamjen e një qyteti. Në këtë periudhë mendohet të jetë ndërtuar teqja e “Baba Skënderit”. Në vitin 1894-1896 Qendra e Kazasë së Myzeqesë (nënprefektura), kaloi nga Karbunara në Lushnje.

Turizmi Natyror

Liqeni Gjyshaj	10
Liqeni Kasharaj	12
Liqeni Kupas	14

Kap. 1

Liqeni i Gjyshaj



Liqeni i Gjyshajt, ndodhet 15 km larg qytetit të Lushnjës, në Njësinë Administrative Ballagat. Përmes një peizazhi piktoresk përreth kodrave të Darsisë, kjo zonë krahasohet shpesh me “Toskanën e Italisë”.






Liqeni Kasharaj

Liqeni i Kasharajt, ndodhet vetëm 2 km larg qytetit të Lushnjës, në Njësinë Administrative Karbunarë, me një peisazh mjaft të bukur, i cili e bën këtë zonë të vizitohet nga shumë turistë.

Në Kasharaj ruhet dhe një monument kulturor-historik (urë) e cila i përket shekujve XII-XIII e kalueshme edhe në ditët e sotme.

E ndërtuar pranë liqenit të Kasharaj, dikur ajo shërbente si rrugë e vjetër për të lidhur trevën e Myzeqesë me Elbasanin.



Liqeni Kupas

Liqeni i Kupasit, ndodhet 15 km larg qytetit të Lushnjës, në Njësinë Administrative Hysgjokaj. Fshati Kupas shtrihet në kodrat e Lushnjës dhe shquhet për prodhimet e dru frutorëve. Liqeni i madh shfrytëzohet për peshkim dhe piknik ndërsa pozicioni gjeografik e bën një pikë turistike tërheqëse.



Turizmi Kulturore

Kongresi i Lushnjës	18
Muzeu Historik Lushnje	20
Kisha e Shën Mërisë Bishqethëm	22
Kisha e Shën Kollit Krutje e Sipërme	24
Kisha e Shën Kollit në Toshkëz	26
Manastiri i Ardenicës	28

Kap. 2

Shtëpia Kongresi i Lushnjës

Shtëpia ku u mbajtë Mbledhja e Kombit e njohur gjerësisht edhe si “Kongresi i Lushnjës”. Kjo shtëpi është ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX. Gojarisht thuhet të jetë ndërtuar në vitin 1851. Në atë kohë pronë e familjes Fuga. Kjo shtëpi është e tipit beratase me dy kate ndërsa në çati ka një dhomë të vogël e quajtur ndryshe “konaku i hankove”. Ditën kur u hap kjo shtëpi për të zhvilluar Mbledhjen e Kombit i zoti i shtëpisë Shaqir Fuga kishte ndërruar jetë bashkëshortja dhe i biri Kasem (Kaso) Fuga i cili ishte vetëm 17 vjeç pranuan pa asnjë hezitim që mbledhja të zhvillohej në shtëpinë e tyre.

Gjatë Luftës Dytë Botërore shtëpia u dëmtua shumë. Një dhomë shtesë e saj në pjesën lindore nuk ruhet më.

U hap si shtëpi muze më 21 Janar 1960 ku me atë rast u bë dhe një kronik televizive nga Radio Televizioni Shqiptar.



Muzeu Historik



Ideja për ngritjen e Muzeut Historik, daton në vitin 1982.

”Në dokumente, thuhej ndër të tjera se, vendi ku do të ndërtohej muzeu duhet të ishte pranë qendrës dhe buzë rrugës. Muzeu duhet të kishte një arkitekturë bashkëkohore dhe të veçantë nga ndërtesat e tjera të qytetit, duhet të pasqyronte historinë e qytetit të Lushnjë nga lashtësia e deri në vitet '80, të kishte edhe një hapësirë të veçantë kushtuar Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Gjithashtu duhet të kishte kënd të veçantë kushtuar Arkeologjisë, Reformës Agrare, Arsimit dhe Luftës ndaj Analfabetizimit, Shëndetësisë, Etnografisë, etj. Muzeu duhet të kishte nivel të lartë shkencorë sepse ndërtohej pas Muzeut Kombëtar në Tiranë dhe disa muzeve të tjerë të vendit”. Zyrtarisht Muzeu u përuhua më 21 Nëntor 1990.



www.lushnja-explore.al

Kisha e Shën Mërisë (Bishqethëm, Lushnjë)

Kisha e Shën Mërisë Bishqethëm është një objekt kulti tipik i ndërtimeve të shek. XVIII. Pikturat janë realizuar nga Johani i cili i përket familjes së Çetirëve nga Grabova, në vitin 1798. Disa prej tyre ruhen në gjendje të mirë dhe përbëjnë një faktor të rëndësishëm kulturor për t'u vizituar.

Frekuentohet gjerësisht nga besimtarët. Gjendet në afërsi të rrugës automobilistike Fier-Lushnje, në pjesën lindore të saj, në një distancë 12 km nga Fieri dhe 500m nga autostrada Fier-Lushnje. Shkohet me makina të vogla dhe autobuz.



Kisha e Shën Kollit (Krutja e Sipërme)

Kisha e Shën Kollit mendohet të jetë ndërtuar në mesin e shek. XVIII. Ajo është pikturuar më 17 shkurt në vitin 1811 nga Nikolla Çetiri nga Grabova. Hyrjet e kishës janë hapur nga ana perëndimore ndërmjet dy dritareve, në anën veriore dhe jugore. Si zakonisht, pjesa perëndimore e hajateve është më e gjerë.

Në një fazë më të vonë, në vitin 1924 është ndërtuar një ambient ndenjeje me dysHEME. Frekuentohet gjerësisht nga besimtarët. Gjetet në afërsi të rrugës automobilistike Lushnje-Fier. Shkohet me makina të vogla dhe autobus.





Kisha e Shën Kollit (Toshkëz)

Kisha e Shën Kollit në Toshkëz është ndërtuar në 1797. Ajo është pikturuar në vitin 1813 nga mjeshtrit Johan dhe Nikolla Çetiri nga Grabova.

Është tipik variant i kishave të Myzeqesë, e përbërë nga Naosi dhe hajatet që e rrethojnë në tri anë.

Frekuentohet gjerësisht nga besimtarët. Gjendet në afërsi të rrugës automobilistike Lushnje-Berat. Shkohet me makina të vogla dhe autobuz.



Manastiri i Ardenicës

Manastiri i Ardenicës ngrihet mbi një kodrinë që dominon fshatin Kolonjë të Myzeqesë. Mbi portën e hyrjes është data 1 maj 1477, që mendohet të jetë data e ndërtimit. Kisha e manastirit i është kushtuar “Lindjes së Shën Marisë” dhe kremton më 8 shtator. Ardenicë ka kuptimin burim uji, ndërsa Theofan Popa në librin “Mbishkrime të kishave të Shqipërisë” thekson se fjala Ardenicë vjen nga greqishtja, që do të thotë “freksuese”. Shën Mëria me lutjet e saj i freskon besnikët nga zjarri i mëkateve. Manastiri rrethohet nga mure guri të lartë. Hyrja për në manastir është nga ana lindore nëpërmjet një porte me qemerë. Oborri është i shtruar me kalldrëm. Hajatet janë dykatëshe dhe shërbejnë si qeli për murgjit. Kati përdhes përdorej si hambar për bereqetin. Në mjediset e manastirit gjendet një mulli për prodhimin e vajit të ullirit. Manastiri i ka fillimet veta në shekullin X me kishëzën e “Shën Triadhës”, e cila ka përmasa të brendshme 5.15×3.06 metra.

Manastiri i Ardenicës ka disa faza ndërtimi. Formën si manastir e ka marrë në shekujt XIII-XIV, në kohën e Despotatit të Epirit. Kisha e “Lindjes së Hyjlindëses” mendohet t’i ketë fillimet e saj në shekujt XV-XVI. Nektar Tërpo Voskopojari ka nënshkruar në një gravurë në manastirin e Ardenicës. Në të është shkruar një lutje e shkurtër drejtuar Hyjlindëses në katër gjuhë, greqisht, latinisht, arumanisht dhe shqip. Gravura ka këtë tekst në shqip të shkruar me alfabetin grek:

“Ανασσα Μητρο Παρθενε / βοηθησον τοις δουλοις σου. Regina mater et Virgo auxilia / re Servis touis. / α ψ λ α (=1731). / ο Ιερομόναχος Νεκτάριος.”

“Virgjin Mamë e perëndis uro prë ne fajtorët”. 1731 Nektar Jeromonaku”. Në gravurë paraqitet Shën Mëria me Krishtin e vogël ndër duar. Ajo daton në vitin 1731 dhe poshtë saj është nënshkrimi i hieromonak Nektarit. Në atë kohë Nektar Tërpo Voskopojari ishte igumeni i manastirit të Ardenicës. Gjithashtu mendohet që në fund të shekullit XVII manastiri të jetë shkatërruar.



Forma e sotme e tij i përket një rindërtimi të shekullit XVIII. Në këtë shekull janë rindërtuar kisha e “Lindjes së Hyjlindëses”, kishëza e “Shën Triadhës”, si edhe pjesë të tjera të manastirit.

Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet në një pllakë guri mbi faqen e jashtme të murit jugor të kishës së “Shën Triadhës”:

”: + Α Ψ Ο Η (=1778) ΜΑΙΟΥ Α. Ανεκαινήσθησαν εκ βάθ / ρων τά γύρουεν κτήρια επί / αρχ(ιερατείας) (τ) ού Β(ε)λ(ε)γ(ράδων) Ιωάσαφ και η / γ(ου)μ(ένου) Κλ(ή)μ(εντος) και μανασσή / Ιερ(ο)μοναχου τε Μωυση ιεροθ(εου), / Ιακώβ(ου) Θεοδοσιου, Δανιήλ, Θεο / κ' λτου, Διονυσί(ου), Ιωαννικίου μονα / χου δε Κυρίλλου και Αθανασίου δ / ιακόνου ων μνησθητι / Κ(ύρι)ε έν τη βασιλεια σου.

“1778 maj 1. U përtërinë prej themeli godinat përqark në kohën kur ishte peshkop i Beratit Joasafi dhe në kohën e igumenëve K.L.M. dhe Manasiut, Jerotheut, Jakovit, Theodhosit, Danielit, Theoklitit, Dionisit, Joanikit dhe murgut Kirillit dhe dhiakon Anastasit, kujtoji o zot në mbretërinë tënde”.

Ky mbishkrim na bën me dije se manastiri është rindërtuar më 1 maj të vitit 1778. Gjithash-tu në murin jugor të kishës së “Shën Triadhës” gjendet një mbishkrim tjetër:

Διεκαιώισθησαν εκ βάθρ(ων) τά γύροθεν κτήρια επί αρχιερατεύοντος Β(ε)λ(ε)γ(ράδων) Κ(υρίου) Βασιλείου επισ(τα)τεύοντος οικ(ο)ν(ο)μου. Χρήστο Λέσι, συμβούλον τέ Σπύρο Γίνη, Ιακόβου Βόσδου, Νικολάου Γέργι ιερέος δε Μάρκου. Υπό τών εκ Δίβρα μαστότων Σαλή και Σα.... Πραμτ. Γριγόρι Ζή.

“U rindërtua prej themeli godinat përreth, në kohën e peshkopatit të Beratit zotit Vasilit në kohën e kujdestarisë të ekonom Kristo Leshit, të këshilltarëve Spiro Gjinit, Jakov Bozdos, Nikollë Gjergjit dhe prift Markut, prej mjeshtërve nga Dibra Sali dhe Sa...Pramt. Grigor Ziu”.

Ndër administratorët e manastirit përmendet Luc Bozdo, i cili ka meremetuar qelitë e dhomat e djegura. Në një rasë guri të shkruar në greqishten bizantine thuhet se më 1905 lkonom Kristo Leshi ka ndërtuar godinat rreth manastirit.

Në vitin 1913 në manastirin e Ardenicës u hap shkolla e parë shqipe me mësues atdhetar lkonom Kozma Dhima. Për pak kohë në vitet ‘ 20 ka shërbyer si internat-kovikt. Në kohën kur ishte kujdestar Llaz Bozo, më 1925 është ndërtuar kambaneria. Në mungesë të buri-meve ujore manastiri përdorte stera për mbledhjen e ujit të shiut. Janë katër të tilla, nga të cilat mund të përmendim sterën pus, atë jugore që ndodhet ngjitur me kishën e madhe, sterën ngjitur me kishën e vogël, etj.


Manastiri “Lindja e Shën Marisë” në Ardenicë zë një sipërfaqe prej 2500 metra katrorë dhe ka pasur në pronësi: 1-toka bujqësore 1900 dynymë, 2-kullota 1504 dynymë, 3-korije 397 dynymë, 4-livadhe 576 dynymë, 5-pyje rreth manastirit 20 dynymë, 6-drurë frutorë 3 dynymë, 7-rrënjë ullinj 1050 copë etj. Në muajin shkurt të vitit 1754 është ndërtuar hajati i kishës. Kjo vërtetohet me anën e një mbishkrimi të gdhendur në gur mbi harkun e parë të kolonës së hajatit perëndimor të kishës.

Prej tre vitesh është rikthyer tashmë si festë lokale “Kurorëzimi i Gjergj Kastriot -Skënder-beut me Donika Arianitin.



LUSHNJA EXPLORE



An aerial photograph of a rural village. A river flows through the center, with a road crossing it. The landscape is a mix of green fields, some brown plowed fields, and clusters of houses with red and white roofs. The surrounding area is densely wooded.

www.lushnja-explore.al

Ky material është publikuar në kuadër të projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës ALTRI dhe Be the Change dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).